



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Prilideno Me/Dena		25-01-2022		Vitet	
Nr./ organit	Numri/Broj	Shtetëse	Vlera	Vendoset	
Org.broj		Prilog			
02-085/02-90					

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë

Opština Vitina

Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 ,17 paragrafi 17.1 **pika e** të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 në harmoni me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491 të dates 21.04.2011,lidhur me nenin 5 paragrafi 3 pika 3.2 të Ligjit për Mbrojtjen e mjedisit Nr. **03/L-025**, Kryetari i Komunës në bazë të kompetancave dhe autorizimeve që ja lejon ligji bjen këtë:

V E N D I M

Për Shpalljen e Vitit 2022 vit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe mbrojtjes së Pyejeve në teritorinë e Komunës së Vitisë

Neni I

Ky vendim rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni II

Vlerat e mbrojtura të mjedisit përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit

Neni III

Shfrytëzimi dhe mbrojtja e mjedisit bëhet përmes planifikimit për ruajtjen e cilësisë dhe llojllojshmërisë së tyre, në përputhje me kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet e veçanta.

Neni IV

Komuna e Vitisë angazhohet për zvoglim gradual të ndotjes,degradimit dhe dëmtimit mjedisor si dhe ndalimin e aktiviteteve ekonomike të cilat gjenerojnë rrezik në shkatërrimin e biodiversitetit natyror,dhe paraqesin rrezik për shëndetin e njerzve dhe të mjedisit.

Neni V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës

z.Sokol Haliti

